

REPubLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. 14064 Regj.

14064

V E N D I M

PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane, sot me daten 08.03 1996, une Florona Tegu  
gjyqtare ne gjykatën e rrethit Tirane, si shqyrtova kërkesën e Gjon Curraj  
datelindjes 1950, me banim ne Komunen e Bajzes, Malsi e Madhe per regjistrimin si  
person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "CURRI "SH.P.K. dhe:

K O N S T A T O V A :

Se kerkohet regjistrimi si person juridik nga kjo gjykate i shoqerise  
me pergjegjesi te kufizuar "CURRI "SH.P.K., me seli ne adresen Komuna e Bajzes  
Malsi e Madhe, me ortak te vetem dhe administrator Gjon Curraj, me kapital  
fillestar 100.000 leke, me kohezgjatje mbi 10 vjet te aktivitetit dhe me objekt  
te veprimtaris qe konsiston ne : ne fushen e tregetise me shumice e pakice dhe  
import eksport te artikujve ushqimor, piqe freskuese e alkoolike, te artikujve  
industrial e elektroshtepiak, bujqesor e blektorat, te hidrokarbureve, materiale  
ndertimi, konfeksioneve e metrazheve, lende drusore dhe produkte e nenprodukte te  
drurit, paisje e makineri te ndryshme si dhe pjese ndrimi per to; ne fushen e  
transportit te mallrave, brenda e jashta vendit me automjetet prone e shoqerise.  
Kerkesa e tij eshte e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETO ARESYE :

Ne mbashtetje te ligjit Nr.7638 date 10.11.1992 "Per Shoqerite  
Tregtare", dhe nenit 33 te Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993 "Per Regjistrin  
Tregtar".

V E N D O S A :

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar  
"CURRI "SH.P.K., me qender ne Komun e Bajzes Malsi e Madhe, me ortak te vetem dhe  
administratore Gjon Curraj, me kapital fillestar 100.000 leke, me kohe zgjatje mbi  
10 vjet dhe me objekt veprimtarie qe konsiston ne : ne fushen e tregetise me  
shumice e pakice dhe import eksport te artikujve ushqimor, piqeve freskuese e  
alkoolike, te artikujve industrial e elektroshtepiak, bujqesor e blektorat, te  
hidrokarbureve, materiale ndertimi, konfeksione e metrazhe, lende druri dhe produkte  
e nenprodukte te drurit, paisje e makineri te ndryshme si dhe pjese ndrimi per  
to; ne fushen e transportit te mallrave, brenda e jashta vendit me automjetet  
prone e shoqerise.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne gjykatën e Apelit.

G J Y Q T A R E

*Florona Tegu*  
gajto

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me daten 22 04.1998, une gjyqtare Qulic  
Copo ne Gjykatën e Rrethit Tirane, pasi shqyrtove kerkosen e kerkuesi  
Gjon Curri, i cili kerkon depozitimën e vendimit te asamblese se ortakeve  
date 20.04.1998.

K O N S T A T O V A

Me vendimin e Gjykeses se Rrethit Tirane, nr 14064, date 4.03.1996  
1996 eshte regjistruar si person juridik shqerise ne pergjegjesi te kufi-  
zuar "CURRI" SH.P.K. Malsi e Madhe, me ortak dhe administrator te vetem  
Gjon Curri, me kapital 100 000, me seli ne Bajze, me kohëgjatje nbi 10 vje-  
dhe me objekt te vprintarise;

Tregtim me shumice dhe me pakice, import-eksport te artikujve te  
ndryshem si industrial, elektroshteptiak, bujqesore, etj.

Me vendimin e asamblese se ortakeve eshte vendosur shtimi i  
objektit te vprintarise per te ushtruar dhe tregtim te artikujve farma-  
ceotike dhe kozmetike, depozitimën prane regjistrin tregtare ne Gjykatën e  
Rrethit Tirane te vendimit date 20.04.1998 te asamblese se ortakeve te  
shqerise "CURRI" SH.P.K..

KERKESA E KERKUESIT ISHTE E DREJTE DHE SI E TILLE DUHET PRANUAR

PER KETO ARSYE:

Ne baze te ligjes nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtare

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses, depozitimën prane regjistrin tregtare te  
vendimit te asamblese se ortakeve, date 20.04.1998 qe ben fjale per  
shtimin e objektit te vprintarise per tregtim te artikujve farmaceutike  
e kozmetike.

Urdherohet sekretaria prane regjistrin tregtare te pasqyroje nd  
ndryshimet duke e ndare regjistrin nga numri rendor 1 ne nr 2( a )  
4 e 5 duke e ndare regjistrin me nje vije te kuqe.

GJ Y Q T A R E

1 Qulic Copo 1

Cy

VENDIM  
( I gjyqtarit te vetem )

Sot ne Tirane, me daten 21.10.2003, une M Dogfo  
gjyqtare ne gjykatën e shkallës së Parë Tirane, pasi pashe materialet dhe kërkesën e  
Gjon Ndok Curraj, i datelindjes 1950, banues ne Malesi e Madhe, administrator i  
vetem i shoqërisë "CURRI" sh.p.k. për depozitimin e Vendimit nr-2- date 13.10.2003  
te ortakut te vetem te shoqërisë Tregtare "CURRI" sh.p.k..

KONSTATOVA SE

Me vendimin e gjykates se rrethit Tirane me nr. 14064 date 04.03.1996, eshte  
rregjistruar si person juridik shoqëria tregtare "CURRI" sh.p.k... me ortak te vetem  
Gjon Curraj i cili eshte dhe administrator i vetme e kesaj shoqërie.  
Me vendimin e gjykates se Tiranes nr 14064/1 (5158) date 22.04.1998 eshte vendosur  
shtesa e aktivitetit ekonomik te shoqërisë dhe me tregtim te artikujve farmaceutik e  
kozmetik.  
Me vendimin nr.2 date 13.10.2003 te asamblese se ortakut te vetem te shoqërisë  
"CURRI" sh.p.k., eshte vendosur :

1. Te shtoj aktivitetin e veprimtarise ekonomike te shoqërisë dhe me te gjitha  
llojet e projekteve dhe punimeve te ndertimit te parashikuara per tu  
licensuar nga ministria e turizmit dhe e rregullimit te territorit.
2. Prodhimin e te gjithë artikujve per te cilat kemi te drejten e tregtimit.
3. Depozitimin e ketij vendimi ne regjistrin tregtar.

Meqenese kërkesa i ploteson te gjitha kushtet ligjore ajo eshte e drejte dhe si e  
tille duhet pranuar, ndaj:

PER KETO ARESYE

Duke u bazuar ne Ligjin nr.7632 date 04.11.1992 "Per pjesen e pare te kodit tregtar";  
Ligjin nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqërite tregtare" dhe ligjin nr.7667 date  
28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqërite  
tregtare":

VENDOSA

1. Pranimin e kërkesës.
4. Te shtoj aktivitetin e veprimtarise ekonomike te shoqërisë dhe me te gjitha  
llojet e projekteve dhe punimeve te ndertimit te parashikuara per tu  
licensuar nga ministria e turizmit dhe e rregullimit te territorit.
5. Prodhimin e te gjithë artikujve per te cilat kemi te drejten e tregtimit.
6. Depozitimin e ketij vendimi ne regjistrin tregtar.
3. Urdherimin e zyres se regjistrit tregtare per te bere shenimet ne kolonen  
perkatëse te regjistrit tregtare.
4. Kunder ketij vendimi lejohet ankimi sipas ligjit.

GJYQTARE  
*M Dogfo*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE  
Nr. \_\_\_\_\_

VENDIM

( I gjyqtarit te vetem )

Sot ne Tirane, me daten 12-02-04, une M. Jedu

gjyqtare ne gjykaten e shkalles se Pare Tirane, pasi pashe materialet dhe kerkesen e Gjon Ndok Curraj, i datelindjes 1950, banues ne Malesi e Madhe, administrator i vetem i shoqerise "CURRI" sh.p.k. per depozitimin e Vendimit nr 3 date 04.02.2004 te ortakut te vetem te shoqerise tregtare "CURRI" sh.p.k.

KONSTATOVA SE

Me vendimin e gjykates se rrethit Tirane me nr. 14064 date 04.03.1996, eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare "CURRI" sh.p.k... me ortak te vetem Gjon Curraj i cili eshte dhe administrator i vetme e kesaj shoqerie.

Me vendimin e gjykates se Tiranës nr 14064/1 (5158) date 22.04.1998 eshte vendosur shitesa e aktivitetit ekonomik te shoqerise dhe me tregtim te artikujve farmaceutik e kozmetik.

Me vendimin e gjykates se Tiranës nr 14064/2 date 21.10.2003 eshte vendosur te shtohet perseri aktiviteti ekonomik i shoqerise.

Me vendimin nr.3 date 04.02.2004 te asamblese se ortakut te vetem te shoqerise "CURRI" sh.p.k., eshte vendosur :

1. Gjon Ndok Curraj te leshoj postin e administratorit te shoqerise duke ndenjtur vetem ortak i vetem i shoqerise.
2. Te caktohet si administrator te vetem te shoqerise z.FERD GJON CURRAJ.
3. Statuti ndryshon vetiu ne perputhje me kete vendim.
4. Depozitimin e ketij vendimi ne regjistrin tregtar.

Megjense kerkesa i ploteson te gjitha kushtet ligjore ajo eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar, ndaj:

PER KETO ARESYE

Duke u bazuar ne Ligjin nr.7632 date 04.11.1992 "Per pjesen e pare te kodit tregtar"; Ligjin nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjin nr.7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare":

VENDOSA

1. Pranimin e kerkeses.
2. Depozitimi i Vendimit nr 3 date 04.02.2004 te ortakut te vetem te shoqerise Tregtare "CURRI" sh.p.k. ne te cilin eshte vendosur:
  - Gjon Ndok Curraj te leshoj postin e administratorit te shoqerise duke ndenjtur vetem ortak i vetem i shoqerise.
  - Te caktohet si administrator te vetem te shoqerise z.FERD GJON CURRAJ.
  - Statuti ndryshon vetiu ne perputhje me kete vendim.
  - Depozitimin e ketij vendimi ne regjistrin tregtar.
3. Urdherimin e zyres se regjistrin tregtare per te bere shenimet ne kolonen perkatese te regjistrin tregtare.
4. Kunder ketije vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

GJYQTARE

*Marije Jedu*  
*F. Jedu*

## VENDIM

### IGJYQOTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me daten 27/11/2005 une Gjyqtare E. 34 ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane, pasi pashe materialet dhe kerkesen e kerkuesit "Curri" shpk te perfaqsuar nga Gjon Curraj, i biri i Ndoke e Dile, i dtl 02.09.1950, linde e banues ne Bajze, i cili kerkon : 1. Depozitimën e vendimit nr 4 dt 05.11.2005 te ortakut te vetem te shoqerise "Curri" shpk Bajze, per shitjen e kuotes prej 75% te kapitalit themeltar te shoqerise, 2. Depozitim kontrates shitblerjes kuotave nr 2007 rep, nr 921 kol, dt 10.11.2005, 3. Depozitimën e vendimit nr 5 dt 10.11.2005 te shoqerise "Curri" shpk per kalimin e shoqerise nga shoqeri me ortak te vetem ne shoqeri me kater ortake ;

### KONSTATOJ

Se me ane te vendimit nr 14064 dt 04.03.1996 eshte rregjistruar ne Gjykatën e Rrethit Tirane, si person juridik, shoqeria "Curri" shpk Bajze Malesi e Madhe me kapital themeltar 100000 leke me ortak te vetem z. Gjon Curraj, vendim ky i ndryshuar me vendimet nr 14064/1 (5158) dt 22.04.1998 te Gjykates Rrethit Tirane, ndryshuar me vendimin nr 14064/2 dt 21.10.2003 te Gjykates Shkalles Pare Tirane, ndryshuar me vendimin nr 14064/3 dt 12.02.2004 te Gjykates Shkalles Pare Tirane.

Se me vendimin nr 4 dt 05.11.2005 ortaku i vetem i shoqerise "Curri" shpk Bajze Malesi e Madhe ka vendose te shese, me akt noterial, 75 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise "Curri" shpk, ne tre pjese te barabarta, dy pjese nga 25 % djemve te tij **Eduard Curraj** dhe **Ferd Curraj** si dhe nje pjese prej 25 % te kuotave te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie shtetasit **Dorian Sadiku**, duke vendosur qe shoqeria "Curri" shpk te vazhdoje aktivitetin e saj me te njejtin objekt veprimtarie ekonomike e tregtare por me kater ortake duke qene se bashku ortake te shoqerise "Curri" shpk me nga 25 % seicili te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie dhe po ne kete raport do te jete ndarja e dividendeve te fitimeve te realizuara nga shoqeria.

Se me kontraten nr 2007 rep, nr 921 kol, dt 10.11.2005, mes shitesit Gjon Curraj e blesesve Eduard Curraj, Ferd Curraj e Dorian Sadiku eshte realizuar kalimi i 75 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise "Curri" shpk, duke u bere se bashku ortake te shoqerise me nga 25 % seicili te kapitalit te saj.

Se me vendimin nr 5 dt 10.11.2005, pas realizimit te kontrates se shitblerjes, ortakët **Gjon Curraj, Eduard Curraj, Ferd Curraj** dhe **Dorian Sadiku**, te shoqerise "Curri" shpk Bajze vendosin qe shoqeria qe shoqeria "Curri" shpk te vazhdoje aktivitetin me te njejtin objekt veprimtarie tregtare e ekonomike por me kater ortake, duke qene se bashku ortake te shoqerise "Curri" shpk me nga 25 % seicili te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie dhe po ne kete raport do bejne ndarjen e dividendeve te fitimeve te realizuara nga shoqeria. Ortaket vendosin qe shoqeria "Curri" shpk te administrohet nga kater ortakët, **Gjon Curraj, Eduard Curraj, Ferd Curraj** dhe **Dorian Sadiku**, ku gjithseicili do te kete cilesine e administratorit te saj, kryetar i bordit te administratoreve do te jete **z. Gjon Curraj**, ndersa zv/kryetar i bordit te administratoreve do te jete **z. Eduard Curraj**, gjithashtu ortakët autorizojne kerkuesin per te bere depozitimën e vendimeve dhe te kontrates se bashku me ndryshimet perkatese ne statutin e shoqerise ne rregjistrin tregtar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kerkuesi kerkon te beje depozitimin e vendimit Nr 4 dt 05.11.2005 te ortakut te vetem per shitjen e 75% te kuotes se kapitalit themeltar te shoqerise "Curri" shpk Bajze, kontraten nr 2007 rep dhe nr 921 kol dt 10.11.2005 te shitjes te 75 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise "Curri" shpk Bajze, **Eduard Curraj, Ferd Curraj dhe Dorian Sadiku**, si dhe vendimin Nr. 5 dt 1.11.2005 te ortakeve, **Gjon Curraj, Eduard Curraj, Ferd Curraj dhe Dorian Sadiku**, se bashku me ndryshimet ne statut, ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane.

Kerkesa eshte e drejte, dhe si e tille ajo duhet pranuar :

### PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr. 7638,dt. 19.11.1992''Per shoqerite tregtare dhe ligjit nr. 7667 dt.28.01.1993''Per regjistrimin e shoqerive ne regjistrin tregetar

### V E N D O S A

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitimin prane rregjistrin tregtar te Gjykates Rrethit Gjyqësor Tirane te vendimit Nr 4 dt 05.11.2005 te ortakut te vetem per shitjen e 75% te kuotes se kapitalit themeltar te shoqerise "Curri" shpk Bajze.
- Depozitimin prane rregjistrin tregtar te Gjykates Rrethit Gjyqësor Tirane te kontrates, nr 2007 rep dhe nr 921 kol dt 10.11.2005, se shitjes 75 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise "Curri" shpk Bajze ; **Eduard Curraj, Ferd Curraj dhe Dorian Sadiku**.
- Depozitimin prane rregjistrin tregtar te Gjykates Rrethit Gjyqësor Tirane te vendimit Nr. 5 dt 1.11.2005 te ortakeve, **Gjon Curraj, Eduard Curraj, Ferd Curraj e Dorian Sadiku**, te shoqerise "Curri" shpk Bajze me te cilin vendosin :
  - a. Shoqeria "**Curri**" shpk vazhdon aktivitetin me te njejtin objekt veprimtarie tregtare e ekonomike, me kater ortake me nga 25 % seicili te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie e po ne kete raport do te jete ndarja e dividendeve te fitimeve te realizuara nga shoqeria.
  - b. Shoqeria "**Curri**" shpk do te administrohet nga kater ortakët, **Gjon Curraj, Eduard Curraj, Ferd Curraj dhe Dorian Sadiku**, ku gjithseicili do te kete cilesine e **administratorit** te saj.
  - c. **Kryetar** i bordit te administratoreve do te jete **z. Gjon Curraj**, ndersa **zv/kryetar** i bordit te administratoreve do te jete **z. Eduard Curraj**.
  - d. Miratohen ndryshimet ne statutin e shoqerise "Curri" shpk.
- Statuti ndryshon vetiu ne perputhje me kete vendim, sipas aktit bashkengjitur tij.
- Urdherohet Zyra e Rregjistrin Tregtar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen          germa         , si dhe te behet ndarja me vize te kuqe nga njeri rregjistrim tek tjetri.
- Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

GJYQTARE

*Arata*  
*Ej*

**V E N D I M**  
**I GJYQTARES SE VETME**

Në Tiranë, sot me datën 10.12.2005 une Gjyqtare në Gjykatën e rrethit gjyqesor Tiranë M. Ullas, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuessit Gjon Curraj, Eduard Curraj, Ferd Curraj e Dorian Sadiku, te cilet kerkojne depozitim e vendimit nr 06 date 04.12.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "CURRI" Bajze Malesi e Madhe, dhe

**KONSTATOVA**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "CURRI" me seli ne Bajze Malesi e Madhe eshte rregjistruar si person juridik me vendimin e Gjykates se rrethit gjyqesor Tirane nr 14064 date 04.03.1996

Me vendimin e Asamblese se Ortakeve te kesaj shoqerie nr.06 date 04.12.2005 eshte vendosur:

1. Emerimi konkret i Ekspertes Kontabel te Autorizuar Fatmira Kastrati.
2. Ekspertja kontabel e autorizuar te vleresoje rritjen e kapitalit themeltar ne vlere te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "CURRI" sh.p.k. Bajze Malesi e Madhe nga kontribute ne natyre, ne të holla dhe kalim fitimi ne kapital.

Kerkesa e tyre per te pasqyruar ndryshimet qe kane ndodhur ne shoqeri, qe te reflektohen ato edhe ne skeden perkatese te kesaj shoqerie, eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar

**PER KETO ARSYE**


Ne baze te ligjit Nr 7667 date 28.01. 1993 "Per rregjistrimin e shoqerive ne regjistrin tregtar"

**V E N D O S A**

Pranimin e kerkeses se kerkuesevet Gjon Curraj, Eduard Curraj, Ferd Curraj e Dorian Sadiku,, per depozitim e vendimit nr 06 date 04.12.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "CURRI" Bajze Malesi e Madhe, ku eshte vendosur:

1. Emerimi konkret i Ekspertes Kontabel te Autorizuar Fatmira Kastrati.
2. Ekspertja kontabel e autorizuar te vleresoje rritjen e kapitalit themeltar ne vlere te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "CURRI" sh.p.k. Bajze Malesi e Madhe nga kontribute ne natyre, ne të holla dhe kalim fitimi ne kapital.

Te behen ndryshimet perkatese ne skeden e kesaj shoqerie ne kollonen \_\_\_\_\_ me numer \_\_\_\_\_ si dhe te ndahen rregjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE  


REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE  
Nr 14064/5 Vendimi

6

V E N D I M  
I G J Y Q T A R E S E V E T M E

Në Tiranë, sot me datën 28.12.2005 une Gjyqtare në Gjykatën e rrethit gjyqesor Tiranë A. Caço, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuessit Gjon Curraj, Eduard Curraj, Ferd Curraj e Dorian Sadiku, te cilet kerkojne depozitim e vendimit nr 07 date 12.12.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "CURRI" Bajze Malesi e Madhe dhe

K O N S T A T O V A

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "CURRI" me seli ne Bajze Malesi e Madhe eshte rregjistruar si person juridik me vendimin e Gjykates se rrethit gjyqesor Tirane nr 14064 date 04.03.1996

Me vendimin e Gjykates se rrethit Gjyqesor Tirane nr 14064/5 date 12.12.2005 eshte vendosur :

1. Emerimin konkret te Ekspertes Kontabel te Autorizuar zj. Fatmira Kastrati
2. Ekspertja kontabel e autorizuar te vleresoje rritjen e kapitalit themeltar ne vlere te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "CURRI" sh.p.k. Bajze Malesi e Madhe nga kontribute ne natyre, ne të holla dhe kalim fitimi ne kapital.

Me date 12.12.2005 Asamblea e Pergjithshme e Ortakeve me pergjegjesi te kufizuar "CURRI" vendosi:

1. Miratimin e aktit te shtimit te kapitalit themeltar te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "CURRI" Bajze Malesi e Madhe prej 116.376.000 leke.
2. Te kerkoje depozitim e vendimit nr 07 date 12.12.2005 te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve te "CURRI"sh.p.k. Bajze Malesi e Madhe per miratimin e aktit te shtimit te kapitalit themeltar te vleresuar nga ekspertja e emeruar, ne zyren e Rregjistrimit Tregtar prane Gjykates se rrethit Gjyqesor Tirane.

Kerkesa e tyre per te pasqyruar ndryshimet qe kane ndodhur ne shoqeri, qe te reflektohen ato edhe ne skeden perkatese te kesaj shoqerise, eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar

P E R K E T O A R S Y E

Ne baze te ligjit Nr 7667 date 28.01. 1993 "Per rregjistrimin e shoqerive ne rregjistrin tregtar"

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses se kerkuessvet Gjon Curraj, Eduard Curraj, Ferd Curraj e Dorian Sadiku, per depozitim e vendimit nr 07 date 12.12.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "CURRI" Bajze Malesi e Madhe, ku eshte vendosur: Miratimi i aktit te shtimit te kapitalit themeltar te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "CURRI" Bajze Malesi e Madhe prej 116.736.000 leke.

Te behen ndryshimet perkatese ne skeden e kesaj shoqerise ne kollonen \_\_\_\_\_ me numer \_\_\_\_\_ si dhe te ndahen rregjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

GJYQTARE

Anuar Caço  
AG



# URDHER REGJISTRIMI - 14064 -

Me

1.

2.a. "Curri" S.p.A.

b. Bajzë - Korsi e Kodrës.

c. Praga e mallrave të  
të tjera

d. 100000 lekë

3. Adm: Zon Curraj, dtl. 1950,  
li ndodhet në Bajzë.

4. Statuti nënshkruar me datë 6.11.1996

5. Data 04.05.1996 Adm e vjetër

Statuti nr. 5 Flete

Njoftime: a. shoqëria

b. dhomen e tregëtisë

c. organin përkatës financiar

d. zyres së statistikës

Publikime: X

GJYQTARE

I Tegu

→

AKT THEMELIMI

PER KRIJIMIN E SHOQERISE TREGTARE

"CURRI" SH.P.K

NEHI 1

Forma e shoqerise "CURRI" me pergjegjesi te kufizuar "CURRI" SH.P.K., nga ortaku i vetem i saj i saj i datelindjes 1950, me banim ne Komunen e Bajzes Malsi e Madhe



NEHI 2

Qendra e shoqerise do te jete ne Malsin e Madhe Bajze, por ajo ka te drejte te hapte dega, filiale, perfaqsi dhe agjensi edhe ne qytetete te tjera te Republikes se Shqiperise e jashte saj.

NEHI 3

Kohë zgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet, por ortaku i vetem i saj ka te drejte te shtoje ose ta paksoje ate ne perputhje me percaktimet e hera ne statutin e shoqerise dhe legjislacionin ne fuqi.

NEHI 4

Kapitali i shoqerise "CURRI" SH.P.K., do te jete 100.000 leke, prone e ortakut te vetem te shoqerise, por ai ka te drejte ta shtoje ose ta paksoje ate.

NEHI 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete ne fushen e tregetise me shumice e pakice dhe import eksport te artikujve te ndryshem ushqimor, pijeve freskuese e alkoolike, te artikujve industrial e elektroshtepiak, bujqesor e blektoral, te hidrokarbureve (karburanteve), materiale nderlimi, konfeksioneve e metrazheve, lenda drusore dhe produkte e nenprodukte te tije, paisje e makineri te ndryshme si dhe pjese ndrimil per to; ne fushen e transportit te mallrave jashta e brenda vendit me automjetet prone e shoqerise.

NEHI 6

Te ardhurat qe do te realizohen nga zhvillimi i aktivitetit te shoqerise do te perfitohen nga ortaku i vetem i saj.



#### NEZI 7

Organet e shoqerise "CURRI" SH.P.K. jane Asambleja e Ortakeve, Administratori i shoqerise dhe Komisioni i Revizionit.

#### NEZI 8

Administratori i shoqerise do te jete ortak i saj i vetem Gjoni Ndok Curraj.

#### NEZI 9

Administratori i shoqerise ka ato te drejta dhe detyrime qe percaktohen ne statut dhe ne legjislacionin ne fuqi te Republiks se Shqiperise.

#### NEZI 10

Shoqerita ka te drejte te punesoje persona te ndryshem dhe sipas legjislacionit ne fuqi do te bartoje kontrata te vecanta pune. Mosmariveshjet e punetoreve me shoqerine ,ne rast se nuk zgjidhen me mirkuptim ndermjet tyre do te zgjidhen nga gjykata kompetente.

#### NEZI 11

Ortaku i shoqerise "CURRI" SH.P.K. mund ta shperbeje ate pasi te ketë shlyer me pare te gjitha detyrimet financiare qe rjedhin nga aktiviteti i saj.

#### NEZI 12

Te gjitha qeshtjet e tjera qe kane te bejne me drejtimin e shoqerise "CURRI" SH.P.K., aktivitetin financiar te saj, etj. do te percaktohen me hollesi ne statutin e saj.

#### NEZI 13

E gjithë veprimtaria e Shoqerise Tregetare Private "CURRI" SH.P.K. eshte e mbeshtetur ne aktet ligjore dhe nen ligjore te legjislacionit ne fuqi te Republiks se Shqiperise.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

GJONI CURRAJ



## S T A T U T

### I

#### SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

##### " CURRI " SH.P.K

###### NERI 1:

Formohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar " CURRI " SH.P.K. nga ortakut i vetem Gjon Ndok Curraj, i datelindjes 1950, me banim ne Komunen e Bajzes Malsi e Madhe.

##### VENDE QENDRIMI

###### NERI 2:

Vend qendrimi legal i shoqerise se me sipërme eshte ne Malsin e Madhe, ne Komunen e Bajzes, por ajo ka te drejte te ushtroje aktivitetin e saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise.

##### KOHE ZGJATJA

###### NERI 3

Kohe zgjatja e veprimtarise ekonomike dhe financiare e kesaj dege eshte mbi 10 vjet, por ajo mund te shperbehet ne çdo kohe.

##### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

###### NERI 4

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie do te konsistoje ne fushen e tregetise me shumice e pakice dhe import eksport te artikujve te ndryshem ushqimor, pijeve freskuese e alkoolike, te artikujve industrial e elektroshtepiak, bujqesor e blektorat, te hidrokarbureve (karburanteve), materiale ndertimi, konfeksione e metrazhe, lende drusore dhe produkte e nenprodukte prej druri, pajse e makineri te ndryshme si dhe pjese ndrimi per to; ne fushen e transportit te mallrave me automjetet prone e shoqerise.

##### KAPITALI SHOQERISE

###### NERI 5

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 leke ,i formuar teresisht nga ortakut i vetem i saj Gjon Ndok Curraj.

  
NENI 6

Kapitali i shoqerise munde te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marre organi me i larte i saj, asambleja e ortakëve ose ortakut i vetem.

#### DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 7

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "CURRI" SH.P.K., eshte prone ekskluzive e ortakut te vetem Gjon Curraj, i cili drejton veprimtarine ekonomike te saj duke u mbeshtetur mbi te drejten e prones private dhe te mjeteve te investuara ne shoqeri.

NENI 8

Shoqeria e mesiperme deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky statut dhe ato te legjislacionit Shqiptar ne fuqi. Kjo shoqeri fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin e saj ne Gjykatën e Rrethit Tirane si person juridik, ndersa ushtron aktivitetin ekonomik me regjistrimin ne organin perkates Tatimor . Aktivitetin e pershkruar ne nenin 4 te ketij statuti shoqeria e ushtron per nje afat mbi 10 vjet.

NENI 9


Shoqeria çel llogarine e saj rjedhese ne Bankat e Republikës së Shqipërisë, ajo nuk kufizohet te çele llogari rjedhese dhe ne banka te tjera te huaja. Ajo ka kartën e saj te intestuar si dhe vulen me permbajtje Shoqeria Tregtare "CURRI" SH.P.K.

NENI 10

Shoqeria e mesiperme vepron me te drejten e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet. Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saja kontraktore e jasht kontraktore brenda kapitalit te saj. Shoqeria ka te mbartur rrezikon per veprimtarine e saj ne nivelin e shumes se mjeteve te investuara. Kjo shoqerisheshte prone e themeluesit te saj, merr vendime duke zbatuar ligjet ne fuqi dhe normal e ketij statuti, te cilat jane te detyrueshme per te gjithë punonjesit e saj.

NENI 11:

Shoqeria ka te drejte te punesoje persona fizik vendas dhe te huaj per te realizuar qellimin e fitimit dhe zgjerimit te saj, por vetem me specialiste te kualifikuar, sipas vendimit te organeve drejtuese te saj. Punesimin e ben ne zbatim te kontrates se punes , kolektive ose individuale, sipas rastit dhe ligjit per sigurimet shoqerore dhe Kodit te Punes.





Çdo mosmarrveshje që mund të lindë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë do të zgjidhet me mirkuptim, në të kundërt nga Gjykata kompetente.

**ENI 13:**

Shoqëria ka të drejtë të krijojë fondin e saj të rezervës së kapitalit për zhvillim, për krijimin e rezervës për shperblimin e punonjesve të punësuar në të dhe për krijimin e rezervave të tjera.

**ENI 14:**

Aktiviteti i saj do të zhvillohet kundrejtë çmimeve sipas kërkesës dhe ofertës, në përjashtim të atyre artikujve të përcaktuar me akte nënligjore në çmimet përkatëse. Ajo mund të hapë zyra, përfaqësi, filiale në përputhje me ligjet në fuqi brenda dhe jashtë vendit.

**ENI 15:**

Transferimi i pjesëve të kapitalit themelor duhet të vërtetohet me akt notarial.

**ENI 16:**

Ortaku i vetëm i shoqërisë Gjoni Ndok Curraj është njëkohësisht edhe administratori i saj.

**ENI 17:**

Ortaku i vetëm i shoqërisë, që është dhe administrator i saj, është i veshur me të gjitha fuqitë për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, pa asnjë përjashtim dhe kufizim. Ai ka mundësi të kryejë të gjitha aktivitetet që i konsideron të nevojshme për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Ai ka të drejtë të blejë e të kembejë pasuri, të lidhet me shoqëri të tjera. Ai kryen çdo lloj veprimi pranë të gjitha zyrave shtetërore e private, që kanë të bëjnë me garancitë dhe veprimet ipotekore.


**MARDHENJET E PUNES**

**ENI 18:**

Mardhenjet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çështje që nuk rregullohen me kontratën e punës zbatohen dispozitatë të legjislativës Shqiptare.

Mosmarrveshjet e punonjesve me shoqërinë zgjidhen nga Gjykata e Shqipërisë. Kur pala ankuese, është person i huaj, mosmarrveshjet zgjidhen nga organi që përcaktohet në kontratën e punës.

Punonjësit e emëruar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit që realizon shoqëria gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, nëse në kontratën e punës nuk

  
parashikohet ndryshe. Per punen e tyre punonjesit marrin pagen siq eshte parashikuar ne kontraten e punes.

**NEHI 19:**

Per puntoret e punesuar shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit e sigurimeve shoqerore ne Shqiperi, ndersa te gjithë te punesuarit jane te detyruar te pranojne kete statut te deges.

**NEHI 20**

Administratori i caktuar nga ortakut i vetem, i emeruar me page, nuk munde te marre cilsine e ortakut ne shoqeri dhe as te ushtroje nje aktivitet kontraktues te cfardo lloji per llogari te tij apo te te treteve, pervec atyre te autorizuar nga ortakut i vetem i shoqerise. Per çdo shkelje ne kete drejtim, administratori i emeruar largohet nga puna dhe pergjigjet per demet e shkaktuara.

**NEHI 21:**

Ortakut i vetem i shoqerise cakton dhe administratorët e saj, te cilëve ne aktin e emerimit u percakton detyrat dhe pagen. Po keshtu ben edhe per puntoret e punesuar

**SEKRETI I PUNES**

**NEHI 22:**

Te gjithë te punesuarit ne shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes ne te. Sekret pune paraqesin shkresat materiale dhe aktet, hartat, etj, te cilat ne ligj dhe dispozita te veçanta jane shpallur sekret pune. Te dhena informative, bilance, plane, informacione mbi politiken e shoqerise. Shkresat e mesiperme dhe materiale te tjera u jepen organeve kompetente ne miratimin e organit drejtues.

**PERFAQSIMI I SHOQERISE**

**NEHI 23:**

Perfaqsimi i shoqerise tek te tretet, i perket ortakut te vetem dhe administratorëve te autorizuar prej tij. Ai ka te drejte te perfaqsoje shoqerine edhe ne organet gjyqesore, te caktoje dhe te pushoje avokat ne çeshtje per gjykim.

**NEHI 24:**

Veprimet ekonomike e financiare te shoqerise per vitin e pare te aktivitetit, fillojne me daten e regjistrimit dhe mbyllen me 31 Dhjetor te çdo viti, pervec urdherave te veçante qe jepen nga organi drejtues isaj. Ne fund te çdo periudhe ushtrimore administratori nxjerr bilancin kontabel te deges me rezultatin ekonomik Fitim - Humbje bazuar ne ligjet e rregullat e mbajtjes se



kontabilitetit nga shoqerite private te te percaktuara nga organet kompetente te sistemit fiskal.

Bilanci kontabel miratohet nga organi drejtues i shoqerise. Me miratimin e bilancit kontabel vjetor, ortakut i vetem i saj vendos per krijimin e fondeve te ndryshme per te si fondin e akumulimit, rezerves, stj.

**ENI 25:**

Te ardhurat neto, pas veçimit te fondeve si me sipër, i mbeten ne perdorim plotesisht ortakut te vetem te saj Gjon Curraj.

**SHPERBERJA E SHOQERISE**

**ENI 26:**

Shperberja e shoqerise mund te vije ne çdo kohe dhe per çfardo shkak, si humbje te kapitalit, pamundesi veprimtarie ose me vendim te organit drejtues te shoqerise. Ne kete rast ai cakton nje ose me shume likujdator per te vendosur per menytrat e likujdimit.

**DISPOZITA TE PERGJITHSHE**

**ENI 27:**

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i referohet ortakut te vetem per plotesim si dhe ligjeve te veçanta ne fuqi.

Kryshimet dhe plotsimet ne kete statut behen me te njeften menyre dhe procedure me te cilen nxirret dhe vete statuti.

Ky statut hyn ne fuqi nga dita e nxjerrjes se tij dhe regjistrimit ne Gjykatën e Rrethit Tirane.

Ai firmoset rregullisht nga ortakut i vetem i shoqerise.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

**GJON CURRAJ**

EPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 1993 Rep.Nr. 71P Kol.

**V E R T E T I M**

Sot me datën 6.2 1996, ne dhomen e noterise Tirane u paraqit Gjon Ndok Curraj, i datelindjes 1950, me banim ne Komunen Bajzes Malsi e Madhe, per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi qe me paraqiti, me madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruara, i cili me deklaroi se statuti i shoqerise dhe akti i themelimit te saj shprehin vullnetin e tij te plote e te lire dhe i firmosi keto dokumenta rregullisht para meje. Edhe une noteri, sipas ligjit i vertetoj ato rregullisht.



*Shahu*



def. 5158. alt. 23.04.98.

14064/1

K E R K E S E

- KARAKTERISTIKË : Gjon Curri , i biri i Ndokes , i Bitelindjes 1972, banues ne Bajze te rrethit Malsi e Madhe .
- OBJEKTI : Kerkoj depozitim e vendimit te asamblese se ortakve date 20.04.1998 te shpeshise "CURRI"SH.P.K Malsi e Madhe .ligja nr 7667 date 20.01.1993 Per regjistrin tregtar .
- Perpara : Gjykates se rrethit Tirane .

T I R A N E

Me vendimin e gjykates se rrethit Tirane nr 14064 date 4.03.96 eshte regjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesesi te kufizuar "CURRI"SH.P.K Malsi e Madhe me ortak dhe administrator te vetem Gjon Curri, me kapital 100 000 leke , me kohezgjatje mbi 10 vjet , me seli ne bajze te rrethit Malsi e Madhe dhe me objekt te veprimyarisise Tregtia me shumic dhe me pakic import eksport te artikujve te ndryshem si industrial, elektroshtetor bujqesor , blektoral material ndertimi etj .

Me vendimin e asamblese se ortakve date 20.04.1998 asambleja e ortakve e perfaqesuar nga ortaku i vete Gjon Curri ka vendose te behet shpeshise ne objektin e veprimyarisise veç se ka vendimi i mesiperem i gjykates se rrethit Tirane per te tregtuar dhe artikuj farmaceutik e kozmetik , te depozitohet vendimi i asamblese se ortakve te kesaj shoqerije date 20.04.1998 prane regjistrin tregtare ne gjykatën e rrethit Tirane .

K E R K E S I

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE "CURRI"SH.P.K

/ GJON CURRI /  
*[Signature]*


*[Handwritten notes and signatures]*  
 22.04.98  
 [Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
 QEVERIA E RRITIT SHKODER  
 DREKTORATI I REGJISTRIT TREGTAR  
 NR 1361  
 NR KOL KALONI 756

NOTA NETERE E SHKODER

Sot me daten 20.04.1998 ditën e hene u peracit perpara meje Violeta Sulka j notere ne neterin e rrethit Shkoder i ceketuni Gjon Curri ku per identitet e tij u sigurova ne baze te leternjoftimit personal si dhe te paraqitjes se tij personalisht perpara meje pasi konstatova si ke te gjitha kushtet e kerkuara nga ligja me kerkesen e tij i vertetova nenshtetimin e mesiperem .

N O T E R E

Violeta Sulka j  
  
*[Signature]*

V E N D I M

I O MUNITI TE VLERE TE SHOQERISE ME PERJEGJESI TE KUFIZUAR  
"CURRI" SH.P.K M. Madhe .

Sot me daten 20.04.1998 ditën e hënë në mbledhjen e jashtëzakonshme të asamblesë së ortakëve të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "CURRI" SH.P.K Malsi e Madhe e përfunduar nga ortaku i vetëm Gjon Curri shpërtoj kërkesën për shtimin e objektit të veprimtarisë :

K O N S T A T O J

Në vendimin e gjykatës së rrethit Tiranë nr 14064 datë 4.03.96 është regjistruar si person juridik shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "CURRI" SH.P.K Malsi e Madhe , me ortak dhe administrator Gjon Curri, me kapital 100 000 leke, me kohëzgjatje mbi 10 vjet, me seli në Bajzë të rrethit Malsi e Madhe dhe me objekt të veprimtarisë : tregtia në shumicë dhe me pakicë të artikujve të ndryshëm si industrial, elektroshtepik, bujqësore , materiale ndërtimi etjere .

Kësaj shoqërije i ka liqur nevojën të shtoj objektin e veprimtarisë së kësaj shoqërije dhe është pasqyruar në vendimin e mesipër të gjykatës së rrethit Tiranë për të tregtuar dhe artikuj farmaceutik.

Duke u bazuar në aktet kryesore të kësaj shoqërije si statuti i saj , ligji nr 7667 datë 28.01.1993 Për regjistrimin tregtar .

V E N D O S A

1 ) Të bëhet shtesë në objektin e veprimtarisë së kësaj shoqërije ku të shtohet veç sa është pasqyruar në vendimin e gjykatës së rrethit Tiranë nr 14064 datë 4.01.1996 për të ushtruar dhe tregtia të artikujve farmaceutik e kozmetike.

2) Të depozitohet vendimi i samblësë së ortakëve datë 20.04.1998 i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "CURRI" SH.P.K Malsi e Madhe pranë regjistrimit tregtar ku janë të depozituara aktet e kësaj shoqërije duke pasqyruar ndryshimet përkatëse.

3) Të merret me kontratë punë Eduard Curaj si farmacist në këtë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

ORTAKU I VETËM I SHOQERISE ME PERJEGJESI TE KUFIZUAR "CURRI"


REPUBLIKA E SHQIPËSË  
NOTERIA E RRETHIT SHKODER  
NR REPERTORI 1361  
NR KOLEKSIONI 756

/ GJON CURRI /

AUTENTIKIM NENSHKRITIM

